



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA KOMBËTARE E BREGDETIT
DREJTORIA FINANCËS DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Nr. 30/1 Prot.

Tiranë më, 16.01.2026

URDHËR
Nr. 18, Datë 16.01.2026
PËR

**MIRATIMIN E PLANIT TË INTEGRITETIT NË AGJENCINË KOMBËTARE TË
BREGDETIT PËR VITIN 2026-2027**

Në mbështetje të VKM-së nr. 569, datë 17.07.2019, “Për miratimin e kompetencave, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Bregdetit”, si dhe të Vendim nr. 859, datë 26.12.2024 Për Miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2024-2030, Planit të Veprimit 2024-2026 në Zbatim të saj dhe Pasaportës së Treguesve të Performancës, Strategjia Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2024 – 2030;

URDHËROJ:

1. Miratimin e Planit të Integritetit të Agjencinë Kombëtare të Bregdetit për vitin 2026-2027.
2. Ngarkohen nëpunësit e Agjencisë Kombëtare të Bregdetit për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**DREJTORI I PËRGJITHSHËM
XHENI BEQAJ**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA KOMBËTARE E BREGDETIT

PLANI INTEGRITETI
2026-2027

Miraturar me Urdhrin e Brendshëm nr. 18, datë 16.01.2026 të Drejtorit të Përgjithshëm
të Agjencisë Kombëtare të Bregdetit

**GRUPI I PUNËS PËR HARTIMIN E PLANIT TË INTEGRITETIT NË AGJENCINË
KOMBËTARE TË BREGDETIT ËSHTË:**

1. **Z. Xheni Beqaj** me detyrë Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare të Bregdetit;
2. **Z. Gerti Aleksi** me detyrë Drejtor i Performancës, Menaxhimit të Integruar të Zonave Bregdetare dhe Standardeve në Turizëm;
3. **Znj. Eriola Çadri** me detyrë Drejtor në Drejtorinë e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse;
4. **Znj. Gentiana Troplini** me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Performancës, Vlerësimit të Zonave Bregdetare dhe Turistike;
5. **Znj. Lorena Veizi** me detyrë Përgjegjës i Inspektimit dhe Kontrollit;
6. **Znj. Silvia Meta** me detyrë Përgjegjës Sektorit të Kontrollit të Bregdetit dhe Aktiviteteve të Turizmit Detar;
7. **Znj. Teofik Kalleshi** detyrë Përgjegjës i Sektorit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse;
8. **Znj. Xhensilda Bega** me detyrë Specialiste në Sektorin Juridik dhe Ankimeve Administrative;

Ky Plan Integriteti është hartuar në përmbushje të Vendim nr. 859, datë 26.12.2024 *Për Miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2024-2030, Planit të Veprimit 2024-2026 në Zbatim të saj dhe Pasaportës së Treguesve të Performancës, Strategjia Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2024 – 2030.*

Këto objektiva parashikojnë përdorimin sistematik të mekanizmit për evidentimin e hapësirave për korrupsion dhe forcimin e integritetit të nëpunësve publikë, nëpërmjet vlerësimit të riskut të integritetit dhe hartimit, miratimit e zbatimit të planeve të integritetit në të gjitha institucionet e varësisë së Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sportit.

The bottom of the page features several handwritten signatures in blue ink. From left to right, there is a large, stylized signature, followed by a smaller one, then a signature that appears to be 'Kalleshi', and finally a cluster of three smaller signatures on the right side.

TABELA E PËRMBAJTJES

DEKLARATA E INTEGRITETIT INSTITUCIONAL	5
LISTA E SHKURTESAVE	6
1. HYRJE.....	7
2. MIRATIMI I PLANIT TË INTEGRITETIT PËR AGJENCINË KOMBËTARE TË BREGDETIT	12
3. PROCESI I HARTIMIT TË PLANIT TË INTEGRITETIT	13
4. QASJA METODOLOGJIKE	13
5. OBJEKTIVAT STRATEGJIKË 2026-2027.....	14
6. DETYRAT BAZË TË AGJENCISË KOMBËTARE TË BREGDETIT:	14
7. RISQET DHE FAKTORËT E RISQEVE TË INTEGRITETIT	16
7.1. DREJTORIA E INSPEKTIMIT DHE KONTROLLIT PËR SIGURIMIN DHE ZHVILLIMIN E QËNDRUESHËM TË TURIZMIT	16
7.1.1. VLERËSIMI I RISKUT NË SEKTORIN E INSPEKTIMIT DHE KONTROLLIT	17
7.1.2. VLERËSIMI I RISKUT NË SEKTORIN E KONTROLLIT TË BREGDETIT DHE AKTIVITETEVE TË TURIZMIT DETAR.....	18
7.2. DREJTORIA E FINANCËS DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE	20
7.2.1. VLERËSIMI I RISKUT NË SEKTORIN E BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE	20
7.2.2. VLERËSIMI I RISKUT TË INTEGRITETIT NË SEKTORIN E FINANCËS	22
7.2.3. VLERËSIMI I RISKUT TË INTEGRITETIT NË SEKTORIN JURIDIK DHE ANKIMEVE ADMINISTRATIVE	24
7.3. DREJTORIA E PËRFORMANCËS DHE MENAXHIMIT TË INTEGRUAR TË ZONAVE BREGDETARE.....	27
7.3.1. VLERËSIMI I RRSQEVE PËR SEKTORIN E PERFORMANCËS, VLERËSIMIT TË ZONAVE BREGDETARE DHE TURISTIKE	27

7.3.2. VLERËSIMI I RRISQEVË PËR SEKTORIN E BASHKËRENDIMIT TË PROGRAMEVE, PROJEKTEVE ME RËNDËSI PËR ZONAT BREGDETARE	28
8. TRANSPARENCA E PUNËS DHE E VEPRIMTARISË SË AKB-SË, ME AKTORË TË JASHTËM TË INTERESUAR DHE PUBLIKUN	31
8.1. FAQJA ZYRTARE E INTERNETIT	31
8.2. KOORDINATORI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT	31
8.3. VLERËSIMI I PYETËSORËVE TË VETËVLERËSIMIT TË PLOTËSUAR NGA PUNONJËSIT	32
9. PLANI I VEPRIMIT	33
10. MONITORIMI I PLANIT TË INTEGRITETIT	35





DEKLARATA E INTEGRITETIT INSTITUCIONAL

Përballja efektive me korrupsionin për Agjencinë Kombëtare të Bregdetit është tepër e rëndësishme në zbatim të funksioneve që ka kjo Agjenci referuar Vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 569/2019 *“Për miratimin e kompetencave dhe funksionit të Agjencisë Kombëtare të Bregdetit”*, të ndryshuar, duke përfshirë: mbrojtjen dhe zhvillimin e një mjedisi të qëndrueshëm të zonës bregdetare, nëpërmjet monitorimit dhe kontrollit të të gjithë potencialit ekzistues të zonës bregdetare e detare dhe pasurive mjedisore që përfshihen brenda saj, si dhe kontrollin e veprimtarive turistike në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm të turizmit.

Agjencia Kombëtare e Bregdetit ka përgjegjësi dhe funksione kryesore në:

- a) Sigurimin e performancës në zonat bregdetare;
- b) Organizimin e punës për menaxhimin e integruar të zonës bregdetare;
- c) Organizimin e punës për nxitjen e investimeve në zonën bregdetare;
- d) Organizimin e punës për bashkërendimin e programeve, të projekteve zhvilluese me rëndësi për menaxhimin e integruar të zonës bregdetare;
- e) Sigurimin e zhvillimit të qëndrueshëm të turizmit, nëpërmjet inspektimit dhe kontrollit të veprimtarive turistike.

Ky plan integriteti është shprehje konkrete e vullnetit dhe përkushtimit për integritet institucional, si edhe e qëndrimit pro-aktiv për të mbështetur përpjekjet dhe reformat antikorrupsion. Plani përfshin risqet e integritetit sipas fushave funksionale të Agjencisë Kombëtare të Bregdetit dhe masat konkrete për adresimin e tyre. Qëllimi i tij është përmirësimi i praktikave të parandalimit të korrupsionit, si dhe forcimi i rezistencës institucionale ndaj shkeljeve të integritetit.

Dhënia e shembullit personal dhe menaxhimi i integritetit që nga nivelet më të larta drejtuese, duke ndjekur para së gjithash standarde të larta profesionale dhe etikën, do të sigurojnë një brendësim dhe zbatim efektiv të tij nga të gjitha nivelet e institucionit, duke rritur në këtë mënyrë edhe besimin e kredibilitetin institucional.



LISTA E SHKURTESAVE

MTKS - Ministria e Turizmit Kulturës dhe Sportit

SNKK - Strategjia Ndërsektorale Kundër Korrupsionit

GMS - Grupi i Menaxhimit Strategjik

AKB - Agjencia Kombëtare e Bregdetit

ARB - Agjencia Rajonale e Bregdetit

SBNJ - Sektori i Burimeve Njerëzore


VKM – Vendim i Këshillit të Ministrave

NZ - Nëpunësi Zbatues

NA - Nëpunësi Autorizues

KLSH - Kontrolli i Lartë i Shtetit

MVRI - Metodologjia e Vlerësimit të Riskut të Integritetit



Handwritten signatures and initials in blue ink at the bottom of the page. From left to right, there is a large signature, a smaller signature, a signature that appears to say 'F. Keshu zec', a signature that appears to say 'G. Lahu', a signature that appears to say 'B. J.', a signature that appears to say 'C. J.', and a signature that appears to say 'J. J.'.

1. HYRJE

Plani i Integritetit për Agjencinë Kombëtare të Bregdetit 2026-2027.

Kuadri i përgjithshëm ligjor mbi bazën e të cilit funksionon Agjencia Kombëtare e Bregdetit përfshin, por pa u kufizuar vetëm në:

- Ligj Nr. 44/2015 *"Kodi i Procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë"*;
- Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 *"Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë"*, i ndryshuar;
- Ligji Nr.9251, Datë 8.7.2004 *"Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë"*, i ndryshuar;
- Ligj Nr. 111/2012 *"Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore"*, i ndryshuar dhe akteve të tjera nënligjore;
- Ligj Nr. 10 279, datë 20.5.2010 *"Për kundërvajtjet administrative"*;
- Ligj Nr. 49/2012 *"Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative"*;
- Ligj Nr. 152/2013 *"Për nëpunësin civil"*, i ndryshuar;
- Ligj Nr. 99/2024 *"Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë"*
- Ligj Nr. 8480, datë 27.05.1999 *"Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe të enteve publike"*;
- Ligj Nr. 10 296, datë 08.07.2010 *"Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"*, i ndryshuar;
- Ligj Nr. 9936, datë 26.06.2008 *"Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë"*, i ndryshuar;
- Ligj Nr. 25/2018, *"Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare"*;
- Ligj Nr. 71/2017 Për një Shtesë në Ligjin Nr. 92/2014, *"Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar"*, i ndryshuar
- Ligj Nr. 9887, datë 10.03.2008 *"Për mbrojtjen e të dhënave personale"*, i ndryshuar;
- Ligj Nr. 119/2014 *"Për të drejtën e informimit"*, i ndryshuar;
- Ligj Nr. 9367, datë 7.4.2005 *"Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike"*;
- Ligj Nr. 9154, datë 06.11.2003 *"Për arkivat"*, i ndryshuar;



Handwritten signatures and initials at the bottom of the page, including a large signature on the left, a signature in the center, and several initials on the right.

- Ligj Nr. 8457, datë 11.02.1999 "Për informacionin e klasifikuar "Sekret Shtetëror", i ndryshuar;
- Ligj Nr. 162/2020 "Për prokurimin publik";
- Ligj Nr. 7703, datë 11.05.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar;
- Ligj Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar;
- Ligj Nr. 43/2020 "Për Aktivitetet e Turizmit Detar", i ndryshuar;
- Ligj Nr. 93/2015 "Për turizmin", i ndryshuar
- Ligj Nr. 64/2012 "Për peshkimin", i ndryshuar;
- Ligj Nr. 111/2012 "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", i përditësuar;
- Ligj Nr.8690, datë 16.11.2000 "Për Aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën "për Mbrojtjen e Mjedisit Detar dhe të Zonës Bregdetare të Detit Mesdhe, si dhe të 6 Protokolleve shoqëruese";
- Ligj nr. 107/2014, "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar
- Ligj Nr. 9401, datë 19.5.2005 Për Aderimin e Republikës së Shqipërisë në "Marrëveshjen për nxitjen e respektimit të masave ndërkombëtare të menaxhimit dhe të ruajtjes së burimeve nga anijet e peshkimit në det të hapur";
- Ligj Nr. 111/2012 "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", i ndryshuar;
- Vkm Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për rregullat e prokurimit publik" dhe akte të tjera nënligjore për rregullat e prokurimit publik;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 569, datë 17.07.2019, "Për miratimin e kompetencave, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Bregdetit", të ndryshuar;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 285, Datë 29.4.2022 "Për Kriteret e Vendosjes dhe të Funksionimit të Stacioneve Sezonale të Ankorimit/Bregëzimit (ndryshuar me VKM-në nr. 524, datë 1.8.2024) i ndryshuar;
- Vendim Nr. 730, datë 20.10.2016 "Për miratimin e rregullores për kushtet, kriteret, tarifat, afatet dhe procedurën për klasifikimin e strukturave akomoduese", i ndryshuar;
- Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 22, datë 12.1.2018 "Për miratimin e kriterëve e të procedurave për certifikimin e veprimtarisë së agroturizmit dhe ndërtimin e



8

strukturave/objekteve në funksion të tij", i ndryshuar me VKM nr. 583 datë 03.10.2018, nr. 566 datë 31.07.20219, nr. 316 datë 24.05.2023)

- Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 171, datë 27.3.2019 "Për miratimin e rregullores "për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit", i ndryshuar;
- Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 692, datë 05.10.2016 "Për Miratimin e Rregullores "Kriteret për pajisjen me certifikatë për ushtrimin e veprimtarisë së udhërrëfyesit turistik, detyrat, përgjegjësitë dhe kodin e etikës së tyre", (ndryshuar me VKM nr. 521, datë 01.07.2020; nr. 521 datë 01.08.2024), i ndryshuar;
- Vendim i Këshillit të Ministrave nr.709, datë 12.10.2016 "Për Miratimin e Rregullores "Për kërkesat dhe kriteret për ushtrimin e veprimtarisë së Agjencisë së Udhëtimit", i ndryshuar me (VKM nr. 214 datë 09.04.2025)
- Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 845, datë 28.10.2020 "Për miratimin e rregullave të hollësishme për zhvillimin e aktiviteteve turistike detare, që kryhen nëpërmjet mjeteve lundruese për qëllime turistike dhe argëtim";
- Vendim i Këshillit të Ministrave nr.162, datë 02.03.2016 "Për rregullat, procedurat dhe mënyrat e vënies në dispozicion të pasurive të paluajtshme shtetërore në zonat me përparësi zhvillimin e turizmit";
- Vendim i Këshillit të Ministrave nr.710, datë 12.10.2016 "Për miratimin e rregullores për kërkesat dhe kriteret për ushtrimin e veprimtarisë së operatorit turistik";
- Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 711, datë 12.10.2016 "Për miratimin e rregullores për kushtet dhe kriteret për projektimin dhe ndërtimin e strukturave akomoduese", i ndryshuar;
- Vendim nr.2, datë 28.07.2020 i Këshillit Kombëtar të Territorit "Për përcaktimin e zonës me përparësi Zhvillimin e Turizmit Detar dhe Miratimin e Hartës së Aktiviteteve";
- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 160, datë 12.3.2025 "Për përcaktimin e periudhës së shfrytëzimit dhe të nivelit minimal të kapacitetit të shfrytëzimit të strukturave akomoduese";
- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 99 datë 12.2.2025 "Për përbërjen, mënyrën e organizmit e të funksionimit dhe detyrat e Komitetit për të Dhënat Statistikore në Turizëm";



- Udhëzimi Nr. 30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar;
- Udhëzim Nr. 4, datë 31.12.2020 "Mbi kriteret dhe procedurën për certifikimin e operatorëve të turizmit detar";
- Urdhër Nr. 344, datë 31.12.2020 "Për miratimin e kodit të etikës për operatorin e turizmit detar dhe formatit të vetëdeklarimit";
- Urdhër Nr. 243, datë 9.7.2019 "Për Miratimin e Rregullores mbi Procedurën e Klasifikimit të Strukturave Akomoduese ME 4 APO 5 YJE që janë mbajtes të një marke tregtare të regjistruar dhe të njohur ndërkombëtarisht "BRAND NAME", i ndryshuar;
- Urdhri nr. 38, datë 27.01.2022 "Për vendosjen e strukturës së shërbimit në brezin e shërbimeve të stacionit të plazhit";
- Urdhër nr. 754, datë 01.02.2017 "Për kushtet dhe mënyrën e njohjes së Udhërrëfyesit Turistik të Nderit";
- Urdhër Nr. 258, Datë 15.07.2024 "Për Miratimin e Rregullores për Programet e Kualifikimit të Udhërrëfyesve Turistikë dhe Procedurës për Akreditimin e Tyre".

Kuadri i brendshëm rregullator:

Kuadri i brendshëm rregullator në Agjencinë Kombëtare të Bregdetit përfshin një tërësi aktesh me natyrë të përkohshme të lidhura me detyra specifike të miratuara nga Drejtori i Përgjithshëm. Llojet e akteve administrative në veprimtarinë e AKB-së, që përdoren për përmbushjen e funksioneve të saj, të cilësuar dhe në rregulloren e brendshme të AKB-së, janë:

1. "Urdhri", akti nënligjor i Drejtorit të Përgjithshëm me karakter të brendshëm, që vendos rregulla, sjellje të përgjithshme ose rregullon një marrëdhënie konkrete. Urdhri del në bazë dhe në zbatim të ligjit ose Vendimit të Këshillit të Ministrave
2. "Rregullorja", është akt nënligjor i miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm, që shtjellon rregullat dhe procedurat që do të përdoren në kryerjen e një veprimtarie konkrete.



Aktet me natyrë rregulluese të veprimtarisë së punës së AKB-së listohen, por pa u kufizuar, si më poshtë vijon:

- Rregullore e brendshme Nr. 2174/2 prot., datë 05.05.2023 për *"Organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Bregdetit"* ;
- Rregullore Nr. 80, prot datë 13.12.2019 *"Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike"*;
- Urdhër i brendshëm Nr. 13, datë 12.01.2026 për *"Caktimin e personit përgjegjës për prokurimin publik"*;
- Urdhër i brendshëm Nr. 484 prot., datë 07.12.01.2026 *"Për caktimin e koordinatorit për të drejtën e informimit në AKB"*;
- Urdhër i Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Bregdetit, me nr. 7, datë 12.01.2023 *"Për miratimin e Rregullores "Kodi i Sjelljes së Mirë dhe Etikës në Administratë"*;

2. MIRATIMI I PLANIT TË INTEGRITETIT PËR AGJENCINË KOMBËTARE TË BREGDETIT

Miratimi i Planit të Integritetit për Agjencinë Kombëtare të Bregdetit përfaqëson vullnetin institucional për fuqizimin e mëtejshëm të integritetit institucional, transparencës dhe parandalimin e korrupsionit.

Qëllimi i Planit të Integritetit në këtë institucion është:

- Vlerësimi i risqeve të integritetit të cilat komprometojnë aftësinë e Agjencisë Kombëtare të Bregdetit në kryerjen e funksioneve të saj në mënyrë të paanshme dhe të përgjegjshme;
- Vlerësimi i faktorëve të riskut;
- Hartimi i masave të përshtatshme për adresimin e risqeve të evidentuara.

Vlerësimi i risqeve të integritetit dhe faktorëve të tyre është kryer për proceset e punës sipas fushave të veprimtarisë të institucionit, të cilat përfshijnë: fushën e veprimit të sektorit juridik dhe ankimeve administrative, menaxhimin financiar, menaxhimin e burimeve njerëzore, sigurimin e performancës, vlerësimin e zonave bregdetare dhe turistike, vlerësimin e inspektimit dhe Kontrollit të Bregdetit dhe Aktiviteteve të Turizmit Detar.

Plani i Integritetit për Agjencinë Kombëtare të Bregdetit mbështetet në politikat e Qeverisë Shqiptare të orientuara drejt perspektivës për aderim në Bashkimin Evropian, të prezantuara nëpërmjet dokumenteve kyçe, si Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI), Strategjia Ndër-sektoriale e Drejtësisë (SND), Strategjia e Luftës kundër Korrupsionit.



Handwritten signatures and initials at the bottom of the page, including a large signature on the left, a signature in the center, and a signature on the right with the number 12 next to it.

3. PROCESI I HARTIMIT TË PLANIT TË INTEGRITETIT

Procesi i hartimit të Planit të Integritetit në Agjencinë Kombëtare të Bregdetit konsistoi në zbatimin e fazave të mëposhtme:


1. Ngritja e Grupit të punës në bazë të Urdhrit Nr. 05, datë 08.01.2026 "Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e planit të integritetit në Agjencinë Kombëtare të Bregdetit", Urdhrit Nr. 06, datë 08.01.2026 për *"Një shtesë në urdhrin Nr. 05, datë 08.01.2026 "Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e planit të integritetit në Agjencinë Kombëtare të Bregdetit"*;
2. Informimi i detajuar i punonjësve të institucionit mbi metodologjinë dhe aktivitetet e trajnimit e planifikuara për përgatitjen e planit të integritetit;
3. Vlerësimi fillestar i integritetit në të gjithë sektorët përkatës të institucionit (fokus – grupe);
4. Mbledhja e informacionit të nevojshëm të identifikimit, analizimit dhe vlerësimit të risqeve nga çdo sektor;
5. Shqyrtimi dhe analizimi i informacionit dhe i dokumentacionit të mbledhur lidhur me vlerësimin, ekspozimin dhe rezistencën e institucionit ndaj risqeve;
6. Hartimi i masave për trajtimin e risqeve të identifikuar me qëllim përmirësimin e integritetit;
7. Prioritizimi i masave zbatuese dhe rregullatore për minimizimin e risqeve;
8. Miratimi i planit të integritetit.

4. QASJA METODOLOGJIKE

Për procesin e vlerësimit të riskut të integritetit në Agjencinë Kombëtare të Bregdetit në përputhje me MVRI, u përdorën:

Burime parësore dhe burime dytësore:

- Bisedime me punonjësit e institucionit – fokus grupe, për të diskutuar risqet e secilit sektor të çdo drejtorie,
- Analizë e kuadrit rregullator të brendshëm,
- Analizë e veprimtarisë së institucionit dhe e drejtorive përkatëse,
- Pyetësor vetëvlerësimi për punonjësit e institucionit sipas shtojcës 3 të "Metodologjia e vlerësimit të riskut të integritetit për institucionet e qeverisjes qendrore".



Handwritten signatures and initials at the bottom of the page, including a large signature on the left, a signature in the center, and a signature on the right with the number 13 next to it.

5. OBJEKTIVAT STRATEGJIKË 2026-2027

Si rezultat i procesit të vlerësimit të riskut të integritetit, nëpërmjet këtij Plani Integriteti, Agjencia Kombëtare e Bregdetit ka vendosur objektiva të realizueshëm brenda periudhës 2026-2027, nëpërmjet të cilëve synohet që të minimizohen dhe adresohen risqet e konstatuara.

Objektivat strategjikë të Planit të Integritetit 2026-2027 janë:

1. Forcimi i mekanizmave të brendshëm rregullatorë dhe të kontrollit;
2. Rritja e efektivitetit në menaxhimin e burimeve njerëzore dhe informimi periodik i punonjësve në lidhje me urdhrat dhe rregulloret për mbarëvajtjen institucionale dhe sjelljen e punonjësve të institucionit;
3. Menaxhimi i aseteve dhe buxhetit të institucionit;
4. Garantimi i transparencës me publikun.

Këto objektiva strategjikë bazohen dhe përputhen me parimet e menaxhimit të riskut të integritetit të MVRI, me vizionin e Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit, si edhe me paketën e legjislacionit në fushën e anti-korrupsionit, parandalimit të konfliktit të interesit dhe transparencës në sektorin publik. Këto objektiva do të udhëheqin punën e institucionit përgjatë periudhës së parashikuar, duke angazhuar në mënyrë të drejtpërdrejtë të gjitha strukturat dhe nëpunësit përgjegjës.

6. DETYRAT BAZË TË AGJENCISË KOMBËTARE TË BREGDETIT:

1. Ndjekja e procesit të pastrimit të zonës bregdetare nga operatori ekonomik i kontraktuar për realizimin e këtij shërbimi, për periudhën 15 Qershor - 15 Shtator 2026, për Bashkitë Shkodër, Durrës, Kavajë, Rrogozhinë, Divjakë, Fier, Vlorë, Himarë, Sarandë (AKB-ARB).
2. Takime me njësitë vendore, prefekturat dhe institucionet kompetente për zbatimin e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 649/2024 Për miratimin e rregullores "Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit", të ndryshuar, si dhe diskutimin e planit të masave për mbarëvajtjen e sezonit turistik veror 2026 (ARB);
3. Ushtrimi i kontrollit dhe inspektimit në stacionet e plazhit në vijën breguore, për përmbushjen e kriterëve dhe standardeve në bazë të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.

649/2024 Për miratimin e rregullores “Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit”, inspektimi i operatorëve të turizmit detar, sipas ligjit nr. 43/2020 “Për aktivitetet e turizmit detar”, si dhe inspektimi i të gjitha veprimtarive turistike në Republikën e Shqipërisë, në zbatim të ligjit nr. 93/2015 “Për Turizmin”, të ndryshuar, si dhe ligjit nr. 99/2024 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”. (INSPEKTORATI I TURIZMIT);

4. Përgatitja e kontratave për përdorimin e hapësirës së plazhit, për subjektet aplikues për sezonin turistik veror 2026, pas miratimit të tyre nga Grupi Teknik i Shqyrtimit të Aplikimeve, me palë përfituese Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore. (AKB);
5. Monitorimi i zhvillimeve dhe ndërhyrjeve në zonën bregdetare, si dhe bashkëpunimi me institucionet kompetente që operojnë në zonën bregdetare dhe në zonat ku ushtrohen veprimtari turistike. (AKB-ARB);
6. Raportime pranë institucioneve kompetente për të gjitha shkeljet që do të evidentohen në terren, përgjatë monitorimeve të përditshme, me qëllim marrjen e masave për parandalimin e tyre. (AKB-ARB);
7. Monitorimi i parcelave të përcaktuara si plazhe publike, kriterëve dhe standarteve në këto plazhe, sipas përcaktimeve të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 649/2024 “Për miratimin e rregullores “Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit”, të ndryshuar. (AKB-ARB).



7. RISQET DHE FAKTORËT E RISQEVE TË INTEGRITETIT

Në këtë seksion paraqitet në mënyrë të përmblëdhur analiza dhe rezultatet e procesit të vlerësimit të riskut të integritetit në Agjencinë Kombëtare të Bregdetit.

Pas kryerjes së procesit të vlerësimit të riskut në fushat e përgjegjësisë së institucionit, rezultoi se:

Agjencia Kombëtare e Bregdetit u ristrukturua në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit Nr. 217, datë 1.11.2024 *“Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë Kombëtare të Bregdetit”*.

Sa më sipër, struktura e institucionit dhe vlerësimi i riskut sipas sektorëve është si më poshtë:

7.1. DREJTORIA E INSPEKTIMIT DHE KONTROLLIT PËR SIGURIMIN DHE ZHVILLIMIN E QËNDRUESHËM TË TURIZMIT

Në vijim të ndryshimeve ligjore të ndërmarra në kuadër të reformimit dhe riorganizimit të inspektorateve qendrore, mbështetur në ligjin nr. 99/2024 *“Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”*, si dhe në nenin 101 *“Disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 93/2015 “Për Turizmin”, i ndryshuar”*, funksionet monitoruese, inspektuese dhe kontrolluese të veprimtarive turistike, të ushtruara më parë nga Agjencia Kombëtare e Bregdetit, shfuqizohen.

Në këtë kuadër, Drejtoria e Inspektimit dhe Kontrollit për Sigurimin dhe Zhvillimin e Qëndrueshëm të Turizmit përfshihet në fushën e veprimit të ligjit për inspektimin, në zbatim të pikës 3, neni 3 të këtij ligji, ku përcaktohet se institucionet që veprojnë në fushën e inspektimit i nënshtrohen procesit të riorganizimit, i cili miratohet me Vendim të Këshillit të Ministrave, dhe në zbatim të Vendim nr. 408 datë 16.07.2025 *“Për përcaktimin e institucioneve që riorganizohen sipas ligjit për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”*, pika 2 ku citohet *“Funksionet inspektuese të Agjencisë Kombëtare të Bregdetit transferohen në inspektoratet e reja qendrore, që do të krijohen sipas fushave të inspektimit, që mbulojnë ministrinë përgjegjëse dhe sipas parimeve të ligjit nr. 99/2024, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”*.

Handwritten signatures and stamps at the bottom of the page. From left to right: a large signature, a smaller signature, a stamp that reads "Kërkuesi 2026", another signature, a signature with the number "16" above it, and a final signature on the far right.

Gjithashtu, deri në përfundimin e procesit të riorganizimit, funksionet inspektuese vijojnë të ushtrohen sipas strukturës dhe organizimit ekzistues, në përputhje me legjislacionin në fuqi në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

- **Spektori i Inspektimit dhe Kontrollit**
- **Spektori i Kontrollit të Bregdetit dhe Aktiviteteve të Turizmit Detar**

7.1.1. VLERËSIMI I RISKUT NË SEKTORIN E INSPEKTIMIT DHE KONTROLLIT

Spektori i Inspektimit dhe Kontrollit është i përbërë nga 12 inspektorë, dhe Përgjegjësi i Sektorit. Inspektori raporton dhe përgjigjet para përgjegjësit të sektorit, i cili përgjigjet para Drejtorit të Drejtorisë dhe Drejtori përgjigjet direkt para Drejtorit të Përgjithshëm.

Objektivat dhe detyrat funksionale të Sektorit të Inspektimit dhe Kontrollit përfshijnë:

- Koordinon organizimin e punës në mbarëvajtjen e operacioneve të sektorit të Inspektimit dhe Kontrollit;
- Siguron vlerësimin e riskut të subjekteve që janë objekt inspektimi nën përgjegjësinë e sektorit.
- Siguron zbatimin e procedurave dhe praktikave administrative dhe teknike;
- Merr pjesë në inspektim me autorizim të Drejtorit të Përgjithshëm për kontrollin dhe zbatimin e kriterëve dhe kushteve nga subjektet që ushtrojnë veprimtari turistike;
- Bashkëpunon me stafin nën varësi dhe stafin e Agjencisë për të bashkërenduar nevojat që ato kanë për realizimin e punës që ato kryejnë;
- Harton planet mujore të inspektimit për fushën e veprimtarisë së sektorit dhe ndjek realizimin e tij;
- Mbikëqyr procesin e inspektimit dhe mbajtjen e dokumentacionit për çdo proces inspektimi nga inspektorët e sektorit;
- Harton raporte mujore të veprimtarisë së sektorit, si dhe analizën 6-mujore dhe vjetore;
- Monitoron punën e sektorit dhe bën të mundur vlerësimin e aftësive dhe performancën e tyre në punë, duke përgatitur vlerësime me shkrim për këtë qëllim, duke diskutuar këtë proces me anëtarët e stafit dhe duke evidentuar nevojat për përmirësimin e punës së tyre;
- Kryen çdo detyrë tjetër që i ngarkohet nga Drejtori i Drejtorisë ose Drejtori i Përgjithshëm.



Handwritten signatures and stamps are present at the bottom of the page. A large signature is on the left. In the center, there is a date stamp '14.06.2016' and a signature. To the right, there is another signature and a small stamp. The page number '17' is visible on the right side.

7.1.2. VLERËSIMI I RISKUT NË SEKTORIN E KONTROLLIT TË BREGDETIT DHE AKTIVITETEVE TË TURIZMIT DETAR

Spektori i Kontrollit të Bregdetit dhe Aktiviteteve të Turizmit Detar është i përbërë nga 6 inspektorë dhe Përgjegjësi i Sektorit. Inspektori raporton dhe përgjigjet para përgjegjësit të sektorit, i cili përgjigjet para Drejtorit të Drejtorisë dhe Drejtori përgjigjet direkt para Drejtorit të Përgjithshëm.

Objektivat dhe detyrat funksionale të Sektorit të Kontrollit të Bregdetit dhe Aktiviteteve të Turizmit Detar përfshijnë:

- Koordinon organizimin e punës në mbarëvajtjen e operacioneve të Sektorit të Kontrollit të Bregdetit dhe Aktiviteteve të Turizmit Detar;
- Siguron menaxhimin, kontrollin dhe monitorimin e veprimtarisë së sektorit dhe përmbushjes së veprimtarive sipas planit vjetor të miratuar;
- Siguron vlerësimin e riskut të subjekteve që janë objekt inspektimi nën përgjegjësinë e sektorit.
- Mbikëqyr zbatimin e procedurave dhe praktikave administrative;
- Bashkëpunon me stafin nën varësi dhe stafin e Agjencisë për të bashkërenduar nevojat që ato kanë për realizimin e shërbimeve të punës që ato kryejnë, lidhur me sigurimin e transportit me mjetet e punës, etj;
- Merr pjesë në inspektim me autorizim të Drejtorit të Përgjithshëm për kontrollin e respektimit të kërkesave ligjore nga subjektet që ushtrojnë veprimtari në zonat bregdetare si dhe aktivitetet e turizmit detar.

Sektorët e kësaj drejtorie bashkëpunojnë me të gjitha strukturat jashtë Sektorit apo Drejtorisë, me Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave dhe të Zhvillimit të Turizmit në Ministrinë e Turizmit, Kulturës dhe Sportit, si dhe institucionet e varësisë për çështje që lidhen me fushën e veprimit të sektorit.

Përsa i përket mekanizmave të kontrollit, në kuadër të llogaridhënies të strukturat eprorë, sektorët konsultohen me eprorët dhe strukturat përkatëse të specializuara në fushën brenda objektit të veprimtarisë së sektorëve dhe raportojnë mbi mbarëvajtjen në fund të çdo procesi.



Vlerësimi i risqeve

- **Reputacional**

Referuar detyrave dhe objektivave që kanë sektorët e Drejtorisë së Inspektimit dhe Kontrollit për Sigurimin e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Turizmit, niveli i riskut reputacional konsiderohet i ulët pasi këta sektorë kryejnë procesin e inspektimit nëpërmjet sistemit online e-inspektimi, në vendin ku subjekti kryen aktivitetin, në përputhje me rregulloren “Për përcaktimin e procedurës së inspektimeve, si një proces i rregullt administrativ”, kjo për arsye që të mos ketë ekspozim direkt ndaj korrupsionit si dhe për transparencë gjatë këtij procesi të mbajtur në vendin e inspektimit, në praninë e subjektit apo përfaqësuesit ligjor të tij.

- **Financiar**

Referuar detyrave të Sektorit të Inspektimit dhe Kontrollit dhe Sektorit të Kontrollit të Bregdetit dhe Aktiviteteve të Turizmit Detar, për kryerjen e kontrollit tek subjektet që ushtrojnë aktivitet në fushën e veprimit të këtyre sektorëve, inspektorët përdorin logjistikën e institucionit që përfshin përdorimin e mjeteve të transportit dhe karburantit për lëvizjen e tyre. Gjithashtu, për dietat e udhëtimit të inspektorëve, sektori i financës dhe buxhetit parashikon që në fillim të vitit buxhetin e posaçëm dhe risku financiar konsiderohet i mesëm.

The bottom of the page contains several handwritten signatures and initials in blue ink. From left to right, there is a large, stylized signature, a smaller initial 'A', a signature that appears to be 'F. Kallisti' with the year '2026' written below it, another signature, the initials 'SL', a signature with the number '19' written next to it, and a final signature on the far right.

7.2. DREJTORIA E FINANCËS DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

- **Spektori i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse**
- **Spektori i Financës**
- **Spektori Juridik dhe Ankimeve Administrative**

7.2.1. VLERËSIMI I RISKUT NË SEKTORIN E BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Spektori i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse ka si detyrë funksionale procesin e menaxhimit të burimeve njerëzore, rekrutimin dhe përzgjedhjen e stafit nëpërmjet një procesi transparent, identifikimin e nevojave për rritjen profesionale të stafit, si dhe zbatimin e kodit të sjelljes dhe etikës në institucion, me qëllim krijimin e vlerave të qëndrueshme, drejtimin strategjik të politikave dhe planeve, si dhe efikasitetin në kryerjen e detyrave, që të mund të realizohet misioni i Agjencisë Kombëtare të Bregdetit.

Objektivat dhe detyrat funksionale të Sektorit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse përshijnë:

- Drejton procesin e procedurave të punësimit dhe menaxhimit të burimeve njerëzore në Agjencinë Kombëtare të Bregdetit, si dhe mbështet 4 (katër) Agjencitë Rajonale të Bregdetit, duke siguruar një proces objektiv, transparent dhe të hapur.
- Mbështet procesin e ngritjes së sistemeve të kontrollit të brendshëm, nxit përkushtimin e stafit në kryerjen e detyrave funksionale.
- Ndjek plotësimin e librezave të punës dhe pasqyrimi i të gjitha ndryshimeve të pozicionit të punës së stafit.
- Siguron, përgatitjen dhe administrimin e vlerësimeve vjetore të stafit, si dhe asiston dhe bashkëpunon me drejtorët e drejtorive për realizimin e vlerësimeve individuale, konfirmimin e nëpunësve dhe mbarëvajtjen e gjithë procesit.
- Ndjek procesin e procedurave disiplinore të punonjësve, si dhe në bashkëpunim me Sektorin Juridik dhe Ankimeve Administrative, përgatit urdhrat e emërimit, lirimit, kontratave të punës, si dhe kryerjen e lejeve vjetore të stafit.

The bottom of the page contains several handwritten signatures and initials in blue ink. From left to right, there is a large, stylized signature, followed by a smaller signature, then a signature that appears to say 'Tallha 2006', and finally a signature with the number '20' next to it. There are also some other smaller marks and initials scattered around.

- Harton dhe ndjek praktikat e standardizuara të menaxhimit të burimeve njerëzore si dhe sipas rastit, monitoron zbatueshmërinë e urdhrave të titullarëve.
- Kryen kontrollin e njësive të burimeve njerëzore në institucionet e varësisë, si dhe këshillon titullarët.
- Ndjek dhe koordinon punën për përfundimin e praktikave dokumentare, si dhe udhëheq procesin e ristrukturimit dhe reformimit të strukturave të burimeve njerëzore për përmirësimin e zbatimit të politikave të burimeve njerëzore.
- Vlerëson, aftësitë dhe performancën e përgjithshme të specialistëve të sektorit, duke përgatitur vlerësimet me shkrim të rezultateve në punë, duke diskutuar ecurinë dhe duke theksuar fushat në të cilat janë të nevojshme të bëhen përmirësime.
- Siguron ndjekjen e respektimit të orarit të punës, disiplinës dhe etikës në Agjencinë Kombëtare të Bregdetit.
- Mban kontakte me përfaqësues të institucioneve të ndryshme, lidhur me menaxhimin e burimeve njerëzore dhe dokumentacione të ndryshme.

Menaxhimi i burimeve njerëzore është një fushë e rëndësishme, e cila kërcënohet nga risqe me ndikime negative për institucionin. Ato mund të hasen në aspekte dhe etapa të ndryshme të menaxhimit të burimeve njerëzore si emërimi, zgjedhja, transferimi, largimi i personelit nga puna, miratimi, zbatimi apo ndryshimi i strukturës organizative, i rregulloreve, kodeve të ndryshme etj. të cilat mund të cenojnë integritetin e institucionit duke ndikuar drejtpërdrejtë në mirëfunksionimin e tij. Riorganizimi dhe përshtatja e vazhdueshme organizative janë procese të nevojshme në interes të rritjes së eficiencës. Pas analizës së bërë në lidhje me procesin e rekrutimit në strukturat e Agjencisë Kombëtare të Bregdetit, si dhe institucioneve të varësisë, rekrutohen dhe administrohen bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore për nëpunësin civil, sipas kriterëve dhe procedurave të përcaktuara nga Departamenti i Administratës Publike. Ndërkohë, disa pozicione pune në AKB dhe pozicioni i shoferit në AKB dhe në Agjencitë Rajonale të Bregdetit, bëhen konform Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

Në funksion të rritjes së integritetit në strukturat e Agjencisë Kombëtare të Bregdetit dhe minimizimin e risqeve të identifikuar më sipër, në këtë Plan janë parashikuar masat si më poshtë:



Handwritten signatures and stamps at the bottom of the page. One signature is dated 2026. There is a stamp with the number 21.

- Hartimi i zbatimi i procedurave për mbikëqyrjen e vazhdueshme dhe inspektimin e gjendjes fizike dhe kushteve teknike, mirëmbajtjes;
- Procedura të detajuara për pajisjen e zyrave dhe të individëve në momentin e fillimit të punës nga ana e tyre dhe në momentin e shkëputjes së marrëdhënieve të punës;
- Hartimi dhe zbatimi i procedurave standarde të punës.

Sa i përket arkivimit, ruajtjes së informacionit dhe administrimit të dokumentacionit është një fushë me rëndësi në veprimtarinë e Agjencisë Kombëtare të Bregdetit, pasi përbën memorien institucionale të saj. Megjithatë strukturat mbikëqyrëse duhet të sigurohen gjithmonë se klasifikimi i informacionit nuk përdoret si justifikim dhe as bëhet për t'iu shmangur apo fshehur kontrollit dhe se dokumentacioni administrohet në përputhje me parashikimet ligjore.

Disa nga risqet e identifikuara evidentuar në këtë fushë janë:

- Aksesimi në informacionin e klasifikuar i personave të pacertifikuar;
- Lëshimi i informatave konfidenciale tek personat e paautorizuar;
- Kushte të papërshtatshme të sigurisë në ambientet ku administrohet dokumentacioni.

Në këtë kuadër, disa nga masat që do të ndërmerren synojnë zbatimin me rigorozitet të procedurave për arkivimin e shkresave, rritjen e njohurive mbi administrimin e informacionit të klasifikuar; identifikimin dhe përmirësimin e mënyrës së qarkullimit të informacionit etj.

7.2.2. VLERËSIMI I RISKUT TË INTEGRITETIT NË SEKTORIN E FINANCËS

Spektori i Financës ka në strukturë 1 (një) Specialist dhe 1 (një) Magazinier. Ky sektor mbulon një sektor me rëndësi të veçantë që përfshin risqe potenciale lidhur me korrupsionin.

Objektivat dhe detyrat funksionale të Sektorit të Financës përfshijnë:

- Menaxhimi efikas dhe transparent i burimeve që financojnë veprimtarinë e AKB-së, në zbatim të ligjit të buxhetit dhe ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin;
- Hartimi i dokumenteve të Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA);
- Mbështetja dhe ngritja e sistemeve të kontrollit për përdorimin e financimit buxhetor vjetor të Agjencive Kombëtare të Bregdetit.
- Asiston në përgatitjen e projekt buxhetit të AKB-së.

The bottom of the page contains several handwritten signatures and initials in blue ink. From left to right, there is a large, stylized signature, followed by a smaller 'A', then a signature that appears to be 'Elisita', and another signature below it. To the right of these are more initials, including 'sf', a signature with the number '22' next to it, and a final small signature on the far right.

- Krijon dhe mban dokumentacionin ekonomik e financiar të AKB-së.
- Asiston në përgatitjen, mbajtjen dhe kuadrimin e balancës së buxhetit të përgjithshëm të AKB.

Vlerësimi i Risqeve

• Reputacional

Për të mundësuar arritjen e objektivave të AKB-së, Sektori i Financës synon të japë siguri objektive për vijimësinë e një aktiviteti normal të institucionit, duke përmbushur nevojat për infrastrukturën e nevojshme dhe shpenzime të tjera operative, duke përdorur me efikasitet, efektivitet dhe ekonomi të gjitha burimet financiare.

Delegimi financiar i vendimmarrjes brenda institucionit është i bazuar në rregullime ligjore dhe hierarkike mbi ekzekutimin e fondeve publike dhe kryerja e pagesave bëhet sipas procedurave të përcaktuara në aktet ligjore dhe udhëzimet përkatëse.

• Financiar

Niveli i riskut financiar përcaktohet si më poshtë:

- Financim i pamjaftueshëm i nevojës për mallra dhe shërbime, çka sjell ulje të infrastrukturës dhe performancës së institucionit,
- Burime financiare të kufizuara për shlyerjen e vendimeve gjyqësore, të cilat në raste të mos-shlyerjes së tyre rezultojnë në vendosjen e sekuestrove mbi fondet e institucionit.
- Diferenca në inventarizim fizik dhe kontabël çka sjell përdorim jo të mirë të burimeve ekonomike.

Strategjitë për menaxhimin e riskut:

Rritja e kontrollit të brendshëm, drejtimi i vazhdueshëm dhe korrekt i proceseve të menaxhimit financiar, por edhe të shpenzimit të shumave të alokuara, përbëjnë masa thelbësore në drejtim të parandalimit dhe uljes së riskut të korrupsionit.

Në funksion të rritjes së integritetit në strukturat e AKB-së dhe minimizimin e risqeve të identifikuara ndaj menaxhimit të aseteve, në këtë plan janë parashikuar dhe janë marrë masat si më poshtë:

The bottom of the page features several handwritten signatures in blue ink. There are also some faint, illegible stamps or markings, including one that appears to say 'Fletë 202'.

- Pajisja me fletë inventarë të përditësuara për çdo punonjës;
- Hartimi dhe zbatimi i procedurave për kontrollin periodik dhe inspektimin e gjendjes fizike dhe kushteve teknike e të mirëmbajtjes së inventarëve nga strukturat përgjegjëse;

Në funksion të rritjes së integritetit në strukturat e AKB-së dhe minimizimin e risqeve të identifikuar ndaj buxhetit, janë parashikuar dhe janë marrë masat si më poshtë:

- Kontroll i dokumentacionit të magazinës dhe sistemit financiar
- Kërkesa për shtesë fondi sipas nevojave të parashikuara që mund të ketë institucioni gjatë vitit.
- Kërkesë për fonde të nevojshme për shlyerjen e vendimeve gjyqësore.

7.2.3. VLERËSIMI I RISKUT TË INTEGRITETIT NË SEKTORIN JURIDIK DHE ANKIMEVE ADMINISTRATIVE

Spektori Juridik dhe Ankimeve Administrative ka në strukturë 2 (dy) specialist dhe Përgjegjësin e sektorit. Specialisti përgjigjet para përgjegjësit të sektorit, i cili varet nga Drejtori i Drejtorisë dhe Drejtori përgjigjet direkt përpara Drejtorit të Përgjithshëm.

Objektivat dhe detyrat funksionale të Sektorit Juridik dhe Ankimeve Administrative përfshijnë:

- Këshillon dhe përgjigjet për bazueshmërinë ligjore për hartimin e drafteve të karakterit juridik si marrëveshje, rregullore, kontrata etj;
- Koordinon punën brenda afateve të përcaktuara për hartimin dhe zbatimin e ligjit në kontratat, akt-marrëveshjet, etj;
- Merr pjesë në hartimin e procedurave dhe standardeve ligjore kur legjislacioni i fushës kërkon një gjë të tillë;
- Përditëson kuadrin ligjor me aktet normative më të fundit që i përkasin fushës së përgjegjësisë së institucionit dhe shpërndan këtë informacion brenda informacionit për zbatim;
- Mbikëqyr dhe evidenton në regjistrin e kontratave dhe akt-marrëveshjeve e të gjitha akteve kontraktuale dhe udhëzon juristin e autorizuar për të ndjekur zbatimin e tyre;
- Përfaqëson Agjencinë në procese juridike/gjyqësore të caktuara.

- Koordinon punën për trajtimin brenda afateve ligjore të kërkesave dhe ankesave nga të tretë.
- Identifikon dhe vepron për zgjidhjen e problemeve ose çështjeve teknike të zyrës.
- Raporton tek eprori i drejtpërdrejtë mbi ecurinë e punës dhe problemet e konstatuara.
- Zbaton rregullat e etikës dhe disiplinës në punë dhe siguron zbatimin e tyre nga ana e vartësve të tij.

Për sa i përket llogaridhënies në strukturat eprorë, ky sektor konsultohet me eprorët dhe strukturat përkatëse të specializuara në fushën brenda objektit të procesit gjyqësor për hartimin e akteve si kërkesë padi, deklaratë mbrojtjeje, prapësime, ankime, rekurse dhe raporton mbi mbarëvajtjen në fund të çdo procesi.

Si i tillë, niveli i riskut të korrupsionit në Sektorin Juridik dhe të Ankimeve Administrative konsiderohet i ulët pasi ky sektor nuk ka procese apo struktura të ndjeshme dhe të ekspozuara direkte ndaj korrupsionit.

Ankimimi Administrativ është një hallkë e rëndësishme e parashikuar në ligj si mjet ligjor për procesin e kundërshtimit të masës administrative përpara procedurës së ankimit në Gjykatë, e për rrjedhojë shqyrtimi i hollësishëm i ankimeve të subjekteve është një domosdoshmëri për vijueshmërinë e procesit.

Gjithashtu, një proces i rëndësishëm është dhe ndjekja e ekzekutimit të detyrimeve monetare ndaj masave administrative të formësuara në titull ekzekutiv deri në arkëtimin e tyre në llogarinë e institucionit.

Vlerësimi i risqeve

Identifikimi i faktorëve të risqeve që lidhen me aspektin e integritetit, të sektorit ligjor, si dhe i impaktit që ata mund të kenë në integritetin e institucionit mund t'i konsiderojmë:

- **Reputacional**

Sektorin Juridik dhe Ankimeve Administrative bën përfaqësimin ligjor të Agjencisë Kombëtare të Bregdetit në bashkëpunim sipas rastit, edhe me specialistë të fushës për çështje të caktuara sipas objektit të padisë. Në çështje që kanë një rëndësi të veçantë në opinionin publik, në gjykim mund

The bottom of the page features several handwritten signatures in blue ink. There are also some faint, illegible stamps or markings, including one that appears to say '25'.

të jenë prezente edhe mediat. Në çdo rast, nëpunësi i këtij sektori përpiqet të bëjë një përfaqësim sa më të denjë, të argumentojë me prova dhe fakte qëndrimet e tij në mënyrë që të mos lërë vend për keqinterpretim.

Nëpunësi i këtij sektori ka përballë në seancë gjyqësore një person që në vetvete është publik dhe për të mbrojtur interesat e institucionit, përdor të gjitha mjetet ligjore të nevojshme.

- **Financiar**

Nga proceset gjyqësore mund të vijnë kosto të larta financiare mbi pagesat e palëve paditëse në sipas objektit të padisë, prandaj nëpunësi i këtij sektori kujdeset gjithmonë që të jetë sa më efektiv në mbrojtjen e interesave të institucionit.

Vonesa e gjykatës për nxjerrjen e Vendimit për titullin ekzekutiv vonon procesin e ekzekutimit të masave administrative.



Telkeshi, 2022



25



7.3. DREJTORIA E PËRFORMANCËS DHE MENAXHIMIT TË INTEGRUAR TË ZONAVE BREGDETARE

- Sektori i Performancës, Vlerësimit të Zonave Bregdetare dhe Turistike
- Sektori i Bashkërendimit të Programeve, Projekteve me rëndësi për zonat bregdetare

7.3.1. VLERËSIMI I RRISQEVE PËR SEKTORIN E PËRFORMANCËS, VLERËSIMIT TË ZONAVE BREGDETARE DHE TURISTIKE

Sektori i Performancës, Vlerësimit të Zonave Bregdetare dhe Turistike ka në strukturë 2 (dy) specialist dhe Përgjegjës të sektorit. Specialisti përgjegjës para përgjegjësit të sektorit, i cili varet nga Drejtori i Drejtorisë dhe Drejtori përgjegjës direkt përpara Drejtorit të Përgjithshëm.

Objektivat dhe detyrat funksionale të Sektorit të Performancës, Vlerësimit të Zonave Bregdetare dhe Turistike përfshijnë:

- Koordinon organizimin e punës në mbarëvajtjen e operacioneve të Sektorit të Performancës, Vlerësimit të Zonave Bregdetare dhe Turistike.
- Përditëson inventarin e Kombëtar të Zonave Bregdetare.
- Siguron mbarëvajtjen e punëve të Sektorit të Performancës, Vlerësimit të Zonave Bregdetare dhe Turistike para Drejtorit të Drejtorisë.
- Jep hollësi në plane pune dhe veprimi për arritjen e objektivave të sektorit/drejtorisë në periudha afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata.
- Siguron përgatitjen e raportit të gjendjes së zonave bregdetare dhe për përgatitjen e raporteve në kuadër të konventave të protokolleve ku vendi ynë është palë.
- Bashkëpunon me stafin nën varësi dhe stafin e Agjencisë në lidhje me performancën dhe vlerësimin e zonave bregdetare.



The bottom of the page contains several handwritten signatures in blue ink. There are also some faint, illegible stamps or markings, including one that appears to say 'Bashkëpunim' and another with the number '2026'.

7.3.2. VLERËSIMI I RRISQEVE PËR SEKTORIN E BASHKËRENDIMIT TË PROGRAMEVE, PROJEKTEVE ME RËNDËSI PËR ZONAT BREGDETARE

Sektori i Bashkërendimit të Programeve, Projekteve me rëndësi për zonat bregdetare ka në strukturë 2 (dy) specialist (një specialist vakant) dhe Përgjegjësin e sektorit (vakant). Specialisti përgjigjet para përgjegjësit të sektorit, i cili varet nga Drejtori i Drejtorisë dhe Drejtori përgjigjet direkt përpara Drejtorit të Përgjithshëm.

Objektivat dhe detyrat funksionale të Sektorit të Bashkërendimit të Programeve, Projekteve me rëndësi për zonat bregdetare përfshijnë:

- Bashkëpunon me organet përkatëse për projektet dhe aktivitetet për mbrojtjen e zhvillimin e bregdetit dhe monitorimin e zbatimit të tyre.
- Nxit dhe bashkëpunon me organizma, institucione, investitorë dhe aktorë të tjerë ndërkombëtar apo vendas dhe i fton ata për pjesëmarrje dhe përfshirje në projekte dhe zhvillime me rëndësi për menaxhimin e integruar të zonës bregdetare.
- Ndjek koordinimin dhe bashkërendimin e brendshme të AKB-së për përgatitjen e analizës sektoriale/analizës së kërkesës (nevojës).
- Identifikimin e prioriteteve, përgatitjen dhe përpunimin e projekt-fushave me planin e programit të AKB/MTKS-së dhe përfshirjen në Planin Buxhetor afatmesëm për financimet e huaja të AKB-së.
- Plotëson fushat e projekteve në përputhje me rregullat e caktuara nga BE dhe donatorët e tjerë.
- Ndjek dhe kontrollon ecurinë e projekteve me financim nga buxheti i shtetit, si dhe ato me donacione të huaja ku AKB-ja është palë.

Vlerësimi i risqeve

Funksionet e përgjithshme të drejtorisë lidhen me menaxhimin e integruar të zonave bregdetare, nëpërmjet zbatimit të praktikave më të mira kombëtare dhe ndërkombëtare të përdorimit të qëndrueshëm dhe promovimit të vlerave të tyre me pjesëmarrjen e palëve të interesuara.



The bottom of the page contains several handwritten signatures in blue ink. One signature is clearly dated "Kallësi 2026". To the right of the signatures, the number "28" is written, followed by a small signature.

Ndër të tjera, puna e Drejtorisë është e përqëndruar në sigurimin e performancës në zonat bregdetare, si dhe në zonën bregujore, me ndryshimet që ka pësuar kuadri ligjor për pjesën e zonave ku ushtrohet aktiviteti i stacionit të plazhit, në zbatimin e politikave në kuadrin e praktikave dhe poçedurave të menaxhimit që ka caktuar Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit, Agjencia Kombëtare e Bregdetit në tërësi, me qëllim që të përmbushet misioni i institucionit. Si dhe institucionet e tjera që ushtrojnë juridiksion në zonat bregujore, sipas kompetencave të tyre të përcaktuara.

Për sa më sipër, nisur nga objektivat dhe detyrat e përcaktuara, është kryer një vlerësim, për identifikimin e risqeve të mundshme që ndikojnë tek kryerja e detyrave funksionale. Deri në këto momente, nuk janë konstatuar raste që çojnë në cënimin e integritetit të nëpunësve, por në funksion të kryerjes së punës me përgjegjshmëri dhe korrektësi rekomandohet që gjatë proceseve të punës të zbatohen standardet me të larta profesionale dhe etike.

- **Reputacional**

Për sa i përket detyrave të lidhura me lidhura me planifikimin e kryesisht me performancën, për shkak të specifikës së këtyre aktiviteteve rekomandohet që punonjësit të kenë një vëmendje të shtuar ndaj zbatimit me përpikëri të kodit etik duke u kujdesur të jenë sa më objektiv, të pandikueshëm dhe të drejtë gjatë monitorimeve dhe mbledhjes, përpunimit e analizimit të të dhënave, me qëllim përmirësimin dhe rritjen e standardeve në shërbime.

Gjithashtu është me rëndësi që objektivat dhe instrumentet e matjes së performancës t'ju sqarohen dhe bëhen me dije njësive përgjegjëse për përmbushjen e tyre, në mënyrë që procesi të jetë sa më korrekt dhe gjithëpërfshirës. Aspekt i cili do të mundësonte rritjen e performancës për realizimin me cilësi dhe në kohë të objektivave dhe prioritetëve të planifikuara për zonën bregdetare, si dhe mbajtjen apo zhvillimin e një sistemi të qëndrueshëm të menaxhimit të informacionit dhe të dhënave për zonën bregdetare, në bashkëveprim edhe me palët e tjera të interesuara.

Bashkëpunimi në realizimin e objektivave të drejtorisë, kërkon angazhimin maksimal dhe të Agjencive Rajonale të Bregdetit, në funksion të marrjes në kohë të informacionit nga terreni, problematikat që konstatohen në zonën bregdetare/bregujore, si dhe ndërhyrja e menjëhershme për zgjidhjen e tyre.



The bottom of the page contains several handwritten signatures in blue ink. One signature is clearly legible as 'Folletti' with the date '2026' written next to it. To the right of this, there is a circular stamp with the number '29' inside. Further right, there is another signature that appears to be 'P. G. H.' and a small mark that looks like 'H'.

Referuar planifikimit, rekomandohet që gjatë këtij procesi të merren në konsideratë të gjithë faktorët që ndikojnë në situatën/potencialin e njësive të varësisë, nevojat për trajnim, si dhe natyrën e problematikave që trajtohen nga institucioni. Në këtë aspekt, rëndësi të veçantë paraqet dhe koordinimi efikas i punës, shkëmbimi i informacionit dhe bashkëpunimi në kohë mes të gjithë drejtorive dhe sektorëve. Rëndësi në këtë aspekt, paraqet mbikëqyrja e vazhdueshme e stafit dhe analizimi i situatave për sigurimin e zgjidhjes më të mirë të mundshme me qëllim rritjes e performancës në zonën bregdetare/bregujore.

Aktualisht, në lidhje me objektivat dhe Drejtoria e Përformancës dhe Menaxhimit të Integruar të Zonave Bregdetare dhe Standardeve në , nuk janë evidentuar risqe, duke qenë se kërkesat për informacion trajtohen brenda afateve të përcaktuara, në përputhje të plotë me përcaktimet dhe standardet e ligjit për të drejtën e informimit duke siguruar efikasitet në kohën e dhënies së informacionit, saktësi të dhënash, transparencë, por dhe me synimin për ofrimin e zgjidhjeve në terren, apo raportimin pranë institucioneve kompetente për ndërhyrje.

Rekomandime

Në vijim rekomandohet që të vijojë të zbatohen në mënyrë të plotë këto standarde duke siguruar përgatitjen e raporteve të gjendjes së zonave bregdetare edhe sipas konventave e protokolleve ku vendi ynë është palë.

Së fundmi, rekomandohet që nëpunësit të konsiderojnë kuadrin ligjor dhe nënligjor, të ndjekin me përpikëri udhëzimet e përditësuara lidhur me proceset e punës për përgatitjen në kohë dhe me cilësi të raporteve si dhe të informohen/trajnohen mbi përcaktimet e planit të integritetit, si dhe nevojat për ndryshime të kuadrit ligjor, me qëllim zbatueshmërinë e parashikimeve ligjore të ndryshme, në funksion të zhvillimit dhe mbrojtjes së zonës bregujore.



The bottom of the page contains several handwritten signatures in blue ink. From left to right, there is a large, stylized signature, followed by a smaller one, then a signature that appears to read 'T. Sh. 2022', and another signature. Below these, there is a large, circular stamp or signature. To the right of this, there is a signature that appears to read '30', and finally, a signature that appears to read 'fu.'.

8. TRANSPARENCA E PUNËS DHE E VEPRIMTARISË SË AKB-SË, ME AKTORË TË JASHTËM TË INTERESUAR DHE PUBLIKUN

8.1. FAQJA ZYRTARE E INTERNETIT

Agjencia Kombëtare e Bregdetit administron një faqe zyrtare web <https://bregdeti.gov.al/> dhe në mënyrë periodike në faqe publikohen të dhënat për veprimtarinë e institucionit dhe informacione të tjera të cilat i shërbejnë publikut, të tilla si:

- Mekanizmat kontrollues dhe monitorues që veprojnë mbi AKB
- Shërbimet që ofrohen nga AKB
- Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve
- Kuadri ligjor rregullator
- Informacion mbi buxhetin
- dhe të dhënat financiare të AKB
- Procedurat/Mekanizmat për të dhënë mendime lidhur me procesin e hartimit të akteve ligjore/nënligjore, politikave publike apo në lidhje me ushtrimin e funksioneve të AKB
- Ndihma shoqërore/subvencione të dhëna nga AKB

8.2. KOORDINATORI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Në zbatim të nenit 10 të ligjit Nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit", Agjencia Kombëtare e Bregdetit me anë të urdhrit Nr. 7 prot., datë 12.01.2026 ka vendosur "Caktimin e koordinatorit për të drejtën e informimit në AKB".

Koordinatori kryen këto detyra:

- a. i mundëson çdo kërkuar të drejtën për t'u njohur me informacionin publik, sipas këtij ligji, duke u konsultuar me dokumentin origjinal ose duke marrë një kopje të tij;
- b. krijon, mban, publikon dhe përditëson regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve brenda afatit të parashikuar;
- c. bashkërendon punën për plotësimin e kërkesave për informacione brenda afateve dhe sipas mënyrës së parashikuar në këtë ligj;
- b) ç) regjistron kërkesat për informacion dhe cakton një numër rendor për secilën prej tyre;



Handwritten signatures and stamps at the bottom of the page. A date stamp "12.01.2026" is visible. The page number "31" is printed on the right side.

- a. dërgon kërkesën për informim te një autoritet tjetër publik, brenda afateve të parashikuara në këtë ligj, kur rezulton se autoriteti publik ku është depozituar kërkesa nuk e zotëron informacionin e kërkuar;
- b. kryen njoftimet paraprake, si dhe komunikon me kërkuuesin, sipas nevojës për trajtimin e kërkesës për informacion publik.

Objekti i informimit publik ka të bëjë me informacionin kryesor mbi veprimtarinë e strukturave të Agjencisë Kombëtare të Bregdetit, nëse lidhet me transparencën e veprimtarisë dhe kontrollin publik, me veprimtaritë me karakter publik në Ministri, ngjarjet e rënda me ndikimet sociale dhe pasoja keqinterpretimi për median e shkruar dhe elektronike, si dhe informacionin e dhënë nëpërmjet konferencës për shtyp dhe/ose publikeve në faqen zyrtare të internetit.

Në lidhje me fushën e veprimit të legjislacionit për të drejtën e informimit, konstatohet se shumica e nëpunësve pjesë e drejtorive politikëbërëse janë të njohur me të dhe nuk kanë problematika për zbatimin e duhur të ligjit. Megjithatë, duke patur parasysh ristrukturimet apo rastet e ndërrimit të personelit për shkak të transferimeve, lëvizjes paralele apo pranimi në shërbim civil, rekomandohet që t'iu bëhet i njohur legjislacioni në fuqi për informimin dhe mbrojtjen e të dhënave personale.

Një nga çështjet që vihet re është mungesa e një akti zyrtar që të rregullojë aspekte të informacionit publik (jo elektronik) që mund të ofrohet ndaj të publikut kundrejt pagesës, duke mbajtur në konsideratë që, një parashikim i tillë është bërë në ligjin për të drejtën e informimit dhe kjo përbën një faktor risku, i cili duhet të trajtohet.

8.3. VLERËSIMI I PYETËSORËVE TË VETËVLERËSIMIT TË PLOTËSUAR NGA PUNONJËSIT

Si një ndër burimet e vlerësimit të riskut të integritetit në Agjencinë Kombëtare të Bregdetit në përputhje me MVRI, u përdor "Pyetëtori vetëvlerësimi për punonjësit e institucionit sipas shtojcës 3 të "Metodologjia e vlerësimit të riskut të integritetit për institucionet e qeverisjes qendrore". Referuar plotësimi të këtij pyetëtori vihet re se disa punonjës nuk janë të informuar në lidhje me rregulloren për "Parandalimin e konfliktit të interesave në AKB" dhe se kush është personi që duhet të informojnë në momentin që kanë konflikt interesi ose konstatojnë se kolegët e tyre mund të jenë në kushtet e konfliktit të interesit.

 The bottom of the page contains several handwritten signatures and initials in blue ink. From left to right, there is a large, stylized signature, followed by a smaller signature, then a signature that appears to say 'Kolektivi 2026', and finally a signature that looks like 'Zelu'. To the right of these, there are more initials and a small signature. The page number '32' is printed at the bottom right, next to a small signature.

9. PLANI I VEPRIMIT

Ndërmarrja e aktiviteteve konkrete nga Agjencia Kombëtare e Bregdetit për përmbushjen e prioriteteve në të gjitha aspektet e operimit të saj, duke siguruar zbatimin e politikave, strategjitë dhe programet e qeverisë të miratuara në fushën e veprimtarisë që mbulon AKB, qëndrueshmërinë dhe vazhdimësinë e veprimtarive përkatëse, për një funksionim sa më eficient dhe efektiv nga pikëpamja e shërbimeve të ofruara.

Në përfundim të hartimit të Planit të Integritetit, me qëllim ruajtjen e integritetit të figurës së nëpunësit, ruajtjen e profesionalizmit, zbatimin korrekt të legjislacionit në fuqi në fushën e menaxhimit të zonave bregdetare, përcaktohet se nëpunësit dhe punonjësit e Agjencisë Kombëtare të Bregdetit duhet të konsiderojnë që:

- 1) Të karakterizohen nga ndershmëria dhe përkushtimi në kryerjen e detyrave, duke zbatuar me rreptësi rregullat që normojnë disiplinën në punë;
- 2) Të ruajnë reputacionin, dinjitetin si dhe të qëndrojnë larg çdo veprimi që mund të cenojë emrin e mirë të tyre apo të institucionit, duke ruajtur të pastër figurën e tyre morale dhe duke shmangur sjellje apo veprime, të cilat cenojnë autoritetin dhe imazhin e tyre para opinionit publik;
- 3) Të reflektojnë standarde të larta të integritetit profesional e personal në ushtrimin e detyrave të tyre, për të siguruar funksionimin sa më transparent, të ndershëm, të drejtë dhe të përgjegjshëm, të fushës së përgjegjësisë së institucionit;
- 4) Të garantojnë mbrojtjen e interesit publik në gjithë aktivitetin e tyre, duke shmangur çdo sjellje që mund të kompromentojë integritetin dhe besueshmërinë e publikut;
- 5) Të shmangin sjellje të paqarta dhe të dyshimta apo çdo diskriminim për shkak të gjinisë, racës, ngjyrës, etnisë, kombësisë, gjuhës, identitetit gjinor, orientimit të bindjeve politike, fetare ose filozofike, gjendjes ekonomike, arsimore ose shoqërore, ose për çdo shkak tjetër.
- 6) Të njihen personalisht me përshkrimin e punës që do të kryejnë sipas pozicionit, duke iu përmbajtur përcaktimeve të tij;
- 7) Të ndërveprojnë në marrëdhënie me njëri –tjetrin me frymën e bashkëpunimit, respektit reciprok, komunikimit korrekt, sjelljes së përshtatshme etj.



Handwritten signatures and stamps at the bottom of the page. The stamps include the date "Kallëtori 2026" and the number "33".

- 8) Të njihen me përditësimet ligjore apo administrative të legjislacionit në fuqi për nëpunësin civil, si dhe Rregulloren e Brendshme të Agjencisë Kombëtare të Bregdetit;
- 9) Të mbajnë në konsideratë parimet bazë të veprimtarisë së institucionit;
- 10) Të mbajnë përgjegjësi të plotë për ligjshmërinë e veprimeve apo mosveprimeve gjatë ushtrimit të detyrës;
- 11) Të respektojnë dispozitat ligjore që rregullojnë konfidencialitetin, informimin publik, konsultimin publik dhe transparencën;
- 12) Të deklarojnë çdo rast të konfliktit të interesit;
- 13) Të respektojnë parimin e trajtimit të barabartë të rasteve, subjekteve apo qytetarëve, parimin e mosneglizhencës së rasteve, parimin e zbatimit të kërkesave ligjore dhe afateve ligjore apo afateve të tjera të caktuar në akte nënligjore;
- 14) Të mos kërkojnë apo të mos pranojnë dhurata, favore, pritje ose çfarëdo përfitimi tjetër, si dhe premtime për to, për veten, familjen, të afërmit, personat ose organizatat me të cilat kanë marrëdhënie, që ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në paanësinë e kryerjes së detyrës, apo janë ose duket sikur janë shpërblim për mënyrën e kryerjes së detyrës zyrtare.
- 15) Të mbajnë në konsideratë forcimin e integritetit institucional, si dhe forcimin e rezistencës institucionale ndaj shkeljeve të integritetit.



F. Kallash 2226



10.MONITORIMI I PLANIT TË INTEGRITETIT

Objektivat strategjikë të këtij plani integriteti, do të implementohen nëpërmjet planit të veprimit, i cili parashikon afatet specifike, strukturat përgjegjëse dhe të dhëna të tjera për secilin aktivitet të parashikuar.

Monitorimi është periodik (çdo 6 muaj) dhe përfshin kryerjen e aktiviteteve nga ana e punonjësve/grupeve të punonjësve përgjegjës, për zbatimin e masave të miratuara në planin e veprimit. Koordinator i caktuar për monitorimin e zbatimit të planit të integritetit është përgjegjës për monitorimin, analizën dhe vlerësimin e nivelit të implementimit të masave dhe aktiviteteve të parashikuara në planin e veprimit.

Monitorimi do të përcaktojë nëse këto masa të zbatuara kanë qenë eficiente, nëse kanë evidentuar ndryshime të kontekstit të institucionit apo ndryshime të vetë risqeve, të cilat mund të kërkojnë rishikimin e masave ekzistuese dhe prioritetëve të risqeve (planit të veprimit), si edhe nxjerrjen e mësimëve për planifikim më të mirë në të ardhmen.



Handwritten signatures in blue ink at the bottom of the page, including a large signature on the left, a signature in the center, and a signature on the right with the number 35 written next to it.

1. Menaxhimi i burimeve njerëzore

Objekti: Forcimi i një sistemi funksional të integritetit në Agjenci përmes fuqizimit të një administrate profesionale dhe efikase

Aktiviteti	Output-i	Afati	Struktura përgjegjëse	Prioriteti	Risku dhe faktorët e riskut	Masa për adresimin e riskut	Burimet
Informimi për rregulloret për etikën dhe konfliktin e interesit të punonjësve të AKB	Punonjës të trajnuar	6M2 2026 - 2027	Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse	I mesëm	Mundësi për mungesë të sjelljes etike dhe profesionale të punonjësve	Zhvillimi i sesioneve të trajnimit me punonjësit	Burimet njerëzore të institucionit
Plotësimi i vakancave në organikën e institucionit	Vakanca të plotësuara	6M2 2026-2027	Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse	I mesëm	Mbingarkesë në përbushjen e detyrave nga funksionale nga punonjësit dhe mundësi për performancë të ulët të institucionit	Emërimi i punonjësve për vendet vakante	Burimet njerëzore të institucionit dhe Departamenti i Administratës Publike

2. Transparenca me publikun

Objekti: Forcimi i një sistemi funksional të integritetit në Agjenci përmes transparencës me publikun

Aktiviteti	Output-i	Afati	Struktura përgjegjëse	Prioriteti	Risku dhe faktorët e riskut	Masa për adresimin e riskut	Burimet
Vijueshmëria e funksionimit të faqes zyrtare në internet	Faqe zyrtare funksionale	6M2 2026 - në vazhdimësi	Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse	I lartë	Pamundësia e publikimeve zyrtare në faqe dhe mosgarantimi i informimit efektiv të publikut	Bashkëpunimi për informacionet që do të publikohen sipas kontratës së shërbimit të lidhur me operatorin ekonomik.	Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse

3. Menaxhimi i buxhetit dhe financës

Objekti: Minimizimi i risqeve të identifikuar ndaj menaxhimit të aseteve dhe buxhetit

Aktiviteti	Output-i	Afati	Struktura përgjegjëse	Prioriteti	Risku dhe faktorët e riskut	Masa për adresimin e riskut	Burimet
Pajisja me fletë inventarë të përditësuara për çdo punonjës	Menaxhimi i mirë i aseteve	6M 2026 - në vazhdimësi	Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse	I ulët	Mospërditësimi në kohë i aseteve në ngarkim të punonjësve, për punonjësit të cilët emërohen apo lirohen nga detyra	Bashkërendimi i sektorit të financës dhe punonjësve	Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse
Diferenca në inventarizim fizik me kontabël	Menaxhimi i mirë i aseteve	6M 2026 - në vazhdimësi	Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse	I ulët	Kontroll i dokumentacionit të magazinës dhe sistemit financiar	Bashkërendimi i specialistit të financës dhe magazinës	Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse
Përgatitja e PBA dhe kuptimi i saktë i indikatorëve dhe kostimit të produkteve të PBA nga grupet e punës (GMS, EMP)	Organizimi i punës në bashkëpunim me sektorët e specialistë të fushës	6M 2026 - në vazhdimësi	GMS dhe EMP	I mesëm	Mos parashikimi në kohë nga grupi i EMP të AKB për produktet dhe aktivitetet brenda afateve dhe për rrjedhojë kostimi me vonesë i tyre	Angazhim më i madh nga grupet GPS dhe EMP	GMS dhe EMP

Dërgimi i pasqyrave financiare në Degën e Thesarit brenda afatit ligjor	Organizimi i punës nga Nëpunësi Zbatues	3M 2026- 2027	Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse	I Lartë	Dërgimi i pasqyrave financiare në Degën e Thesarit jashtë afatit ligjor	Fillimi i përgatitjes së Pasqyrave Financiare që në muajin Janar të vinit pasardhës	Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse
Kërkesa për shtesë fondi sipas nevojave të paparashikuara	Vijueshmëria normale e punës pa cenuar performancën për arritjen e objektivave të institucionit	6M 2026 - në vazhdimësi	Sektori i Financës	I Lartë	Burime financiare të kufizuara për shlyerjen e vendimeve gjyqësore, të cilat në raste të mos- shlyerjes së tyre rezultojnë në vendosjen e sekuestrore mbi fondet e institucionit, si dhe të nevojës për mallra dhe shërbime	Sektori i Financës sipas nevojave të institucionit	Sektori i Financës

GRUPI I PUNËS:

1. Z. Xheni Beqaj me detyrë Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare të Bregdetit;
2. Z. Gerti Aleksi me detyrë Drejtor i Performancës, Menaxhimit të Integruar të Zonave Bregdetare dhe Standardeve në Turizëm;
3. Znj. Eriola Çadri me detyrë Drejtor në Drejtorinë e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse;
4. Znj. Gentiana Troplini me detyrë Përgjegjës i Performancës, Vlerësimit të Zonave Bregdetare dhe Turistike;
5. Znj. Lorena Veizi me detyrë Përgjegjës i Inspektimit dhe Kontrollit;
6. Znj. Silvia Meta me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Kontrollit të Bregdetit dhe Aktiviteteve të Turizmit Detar;
7. Znj. Teofik Kalleshi me detyrë Përgjegjës i Sektorit Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse
8. Znj. Xhensilda Bega me detyrë Specialiste në Sektorin Juridik dhe Ankimeve Administrative;